



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**  
**INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

**VENDIM**  
 Nr. 4, datë 25.01.2021

**PËR VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN E KANDIDATURËS SË Z. SAIMIR HOXHA NË VENDIN VAKANT PËR INSPEKTOR JO MAGJISTRAT, SHPALLUR NGA INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË NË DATËN 07.02.2020.**

KOMITETI I EMËRIMIT EDHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE i përbërë nga :

**Artur Metani - Kryetar**  
**Mirela Kapo - Anëtare**  
**Marsela Pepi- Anëtare**

Asistuar nga sekretare Adela Skora,

në mbledhjen e datës 13.01.2021, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**INSPEKTOR JO MAGJISTRAT**

**Zoti SAIMIR HOXHA**

**OBJEKTI:**

**Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidaturës së Z. Saimir Hoxha, në vendin vakant për Inspektor jo magjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020.**

**KOMITETI PASI :**

U njoh me aktet si edhe bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I. Rrethanat e çështjes**

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në datë 07.02.2020, ka vendosur fillimin e procedurës përzgjedhëse të kandidatëve jomagjistratë që kanë shprehur interes për pozicionin e inspektorit, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka filluar shqyrtimin e aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 209 dhe 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant për Inspektor jo magjistratë në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është edhe zoti Saimir Hoxha.

4. Në zbatim të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të nenit 209 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të gërmës A, pikës 3 dhe 77, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbledhjen e zhvilluar në datën 07.02.2020, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendin vakant për Inspektor jo magjistratë pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

5. Në zbatim të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të nenit 209 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të pikës 27, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pas administrimit të të gjithë dokumentacioni, në mbledhjen e zhvilluar në datën 26.10.2020, është realizuar dhe rradha e shqyrtimit të dosjes që i përket cdo kandidati.

6. Zoti Saimir Hoxha, si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar për Inspektor jo magjistratë pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të

Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me kërkesën me nr.prot 148, në datën 18.02.2020 ka shprehur interes për pozicionin e inspektorit ka shprehur interes për pozicionin e inspektorit, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Rrjedhimisht, nisur dhe nga detyrimet ligjore, kandidati, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati, gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

7. Në datën 29.04.2020, kandidati SAIMIR HOXHA, është paraqitur pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

8. Në datën 06.05.2020, kandidati SAIMIR HOXHA, ka depozituar në sekretarinë e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

9. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve me Vendimin nr. 77, datë 30.10.2020 ka vendosur lejimin e kandidimit të kandidatit Saimir Hoxha për Inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Për rrjedhojë, në bazë të nenit 209 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendin vakant për Inspektor jo magjistratë pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

8. Sipas kalendarit të intervistave të miratuar, në datat 11.01.2021 dhe 12.01.2021, ka zhvilluar procedurën e intervistës me kandidatët e lejuar, mbi motivimin e kandidimit, për gjashtë vendet vakante.

10. Intervista mbi motivimin e kandidimit, Znj. Saimir Hoxha, kandidati për të gjashtë vendet vakante në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, u zhvillua në datën 12.01.2021.

## II. Vlerësimi i Komitetit

10. Në përfundim të intervistës, bazuar në të dhënat e nxjerra nga biseda mbi motivimin e kandidimit, praninë e përfaqësueses së “Euralius”, Znj. Anita Mihailova, si edhe bazuar në aktet dhe dokumentet që janë dorëzuar nga kandidati në momentin e paraqitjes së kërkesës për kandidim, dokumente të paraqitura prej tij sipas kërkesave të Komitetit, si edhe shkresa dhe të dhëna të tjera kërkuara apo të ardhura zyrtarisht nga institucione të ndryshme, Këshilli ka vënë në bisedim vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatit Saimir Hoxha për secilin nga kriteret e vlerësimit të përcaktuara:

- a) në shpjegimet e hollësishme lidhur me metodologjinë mbi të cilin bazohet në vlerësimi dhe caktimi i pikëve të miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

#### **A. Meritat profesionale – Historiku Arsimor dhe Profesional**

11. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Saimir Hoxha, ka ushtruar veprimtaritë profesionale si më poshtë:

- 1) Përmbarues gjyqësor, Ministria e Drejtësisë, 2002-2009;
- 2) Avokatura e shtetit, Ministria e Drejtësisë, 2008-2009;
- 3) Përgjegjës sektori, Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit, 2010;
- 4) Dhoma kombëtare e përmbaruesve, 2010- deri në ditën e bërjes së aplikimit;

#### **Historiku Arsimor**

12. Në shkronjën “**A-HISTORIKU ARSIMOR DHE PROFESIONAL**” të Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, konkretisht në shtojcën nr.2, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe ecuria gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, **diplome e nivelit të dytë të “Master i Shkencave”** me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlefshme me të, ndërkohë që edhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 kërkon të vlerësohen rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë.

13. Prandaj, Komiteti vlerëson me pikë ecuria gjatë kryerjes së arsimit të lartë me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlefshme me të të secilit kandidat, sipas përshkallëzimit me 1 pikë të notës mesatare mbi 8 dhe me 2 pikë të notës mesatare mbi 9, sikurse orientohet në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve.

14. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Saimir Hoxha :

- Ka përfunduar Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës në periudhën 1996-2001, duke u diplomuar “*Jurist*” dhe nota mesatare e studimeve është posht notës 8;
- Ka ndjekur studimet pasuniversitare, në Fakultetin e Drejtësisë pranë Univeristetit publik, në periudhën 2009-2011 dhe duke u diplomuar në Master i Nivelit të Dytë.

15. Sipas certifikatës së notave të lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës , rezulton se ka përfunduar studimet universitare me notë mesatare poshtë notës 8.

16. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “historiku arsimor”, nisur nga nota mesatare e arritur gjatë studimeve dhe diplomimit në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Komitetit çmoi ta vlerësojë kandidatin **Saimir Hoxha me 0 (zero) Pikë**.

### ***Kualifikime Pasuniversitare***

17. Në shkronjën “**A-HISTORIKU ARSIMOR DHE PROFESIONAL**” të Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “*Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, konkretisht në shtojcën nr.2, përcaktohet si kriter vlerësimi **pasja e titujve akademikë, gradave shkencore**, ecuria dhe kryerja kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trainimeve afatgjata dhe afatshkurtra në fushën e të drejtave kushtetuese, të drejtave të njeriut, si edhe në fusha të tjera të së drejtës.

18. Prandaj, në zbatim të ligjit, Komiteti vlerëson me pikë llojin e titujve akademikë dhe gradave shkencore, llojin, kohëzgjatjen, fushën dhe vendin e kryerjes së kualifikimeve pasuniversitare, studimeve, specializimeve dhe trainimeve të kandidatëve, duke pasur parasysh shpërndarjen e pikëve, si edhe orientimet që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor Jomagjistrat.

19. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Saimir Hoxha ka ndjekur studimet pasuniversitare për **Master të Nivelit të Dytë, në Fakulteti I Drejtësisë, Universiteti Tiranës**.

20. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “**Kualifikime pasuniversitar i llojit Master**”. Në total, për këtë kriter vlerësimi kandidati Saimir Hoxha vlerësohet me **1 (një) Pikë**.

21. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Saimir Hoxhaka ndjekur 6 (gjashtë) veprimtari trainimi afatshkurtra te dokumentuara , konkretisht:

### **Lista dhe lloji i trainimeve**

22. Nga aktet që ndodhen në dosjen e kandidimit rezulton se kandidati Saimir Hoxha, ka kryer këto trajnime:

- Periudha mars-tetor 2016.  
Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar “*Justice Cooperation International*”.  
Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Tëinning contract;
- Dhjetor 2012.  
Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar “*Unioni ndërkombëtar i përmbauesve dhe dhoma kombëtare e përmbauesve gjyqësor*”.  
Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Uijh;
- Periudha 02.10-27.11.2009, Paris.  
Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: «*Stazh ndërkombëtar për avokatët e huaj*»  
Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Avocat Paris;
- Periudha janar -maj 2009, Tiranë.  
Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: «*Shkolla e magistraturës në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit Spanjë*»  
Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Magistratura;
- Periudha 2007, Tiranë.  
Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: «*Shkolla e Studimeve Europiane*»  
Emri dhe lloji i institucionit arsimor: bashkim Evropian dhe Diplomacia;
- Periudha 2002-2007.  
Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: «*Certifikata të trajnimeve profesionale , të kurseve për gjuhët e huaja, për kompjuterin etj.*

23. Duke pasur parasysh numrin, llojin, kohëzgjatjen dhe tematikat e veprimtarive trainuese të ndjekura nga kandidati **Saimir Hoxha**, për këtë kriter ligjor vlerësimi Këshilli çmoi ta vlerësojë me **1 ( një ) Pikë**.

#### *Njohja e gjuhëve të huaja*

##### *Gjuhët e huaja*

24. Nga aktet që ndodhen në dosjen e kandidimit rezulton se kandidati ka vetëdeklaruar në jetëshkrim se njih shumë mirë gjuhën Angleze , Frengje dhe gjuhën Italiane. Në gjuhën Frengje kandidati ka dorrëzuar një vërtetim për njohjen e kësaj gjuhe.

25. Për këto arsye, duke pasur parasysh dokumentacionin e administruar, Komiteti çmoi ta vlerësojë kandidatin Saimir Hoxha për këtë kriter ligjor vlerësimi, në total me **1 (një) Pikë**.

#### ***B. Meritat profesionale – Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional***

26. Në shkronjën “**B-KUALIFIKIMI I PËRGJITHSHËM PROFESIONAL**” të Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “*Për miratimin e Rregullores “Për 6 Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr. 13, Tiranë Tel: + 355 4 2217217 <http://www.ild.al> info@ild.al*

*procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, konkretisht në shtojcën nr.2, përcaktohet si kriter vlerësimi, në lidhje me **kualifikimin e përgjithshëm profesional**, përcaktohen si kriteret vlerësimi, në bazë të treguesve shkencorë, performanca e dalluar dhe rezultatet e larta në ushtrimin e profesionit, që mbështetet ndërmjet të tjerave në botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike, në produktet profesionale sipas profileve të ushtrimit të profesionit, rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e dallueshme të arritura gjatë përvojave të tyre të punës e që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse.*

27. Prandaj, në zbatim të ligjit, Komiteti i emerimit dhe vlerësimit të Inspektorëve vlerëson me pikë si sasinë ashtu edhe cilësinë e rezultateve profesionale, me një fokus të veçantë tek cilësia. Në këtë mënyrë, bazuar në të dhënat e mundshme të disponueshme për vlerësim, mbahen parasysh sasia e pikëve maksimale **prej 30 pikësh** sipas urdhërit nr. 7 referuar si më sipër, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe orientimet për caktimin e mundshëm të **një maksimumi prej 25 pikësh për sa i përket vlerësimit cilësor dhe të një maksimum prej 5 pikësh për vlerësimin e sasisë së rezultateve profesionale sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor Jomagjistrat.**

28. Në rastin e kandidatit Saimir Hoxha, Komiteti shqyrtoi dokumente profesionale dhe të dhënat që mund të disponoheshin nga veprimtaria e saj profesionale ndër vite, si edhe nga kontributet e tjera profesionale të këtij kandidatije në veprimtari të ndryshme, përfshirë publikime apo punime e artikuj shkencorë.

29. Për sa i përket vlerësimit sasior, krahas të dhënave që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati,

a) Publikime profesionale dhe kërkime shkencore:

- Kërkimi shkencor me temë “*Analizë mbi shërbimin përmbarimor dhe sfidat e të ardhmës*”, botuar në konferencën shkencore të Universitetit Aleksandër Moisiu dhe Universitetit Albanian University”, në vitin 2014, si autor i parë;(shoqëruar me certifikatë për pjesëmarrje në konferencën shkencore);

Nga aktet që ndodhen në dosjen e kandidimit rezulton se kandidati Saimir Hoxha, ka kryer këto trajnime:

1. Periudha mars-tetor 2016.

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar “*Justice Cooperation International*”.

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Tëinning contract;

2. Dhjetor 2012.

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar “*Unioni ndërkombëtar i përmbaruesve dhe dhoma kombëtare e përmbaruesve gjyqësor*”.

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Uijh;

3. Periudha 02.10-27.11.2009, Paris.

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: «*Stazh ndërkombëtar për avokatët e huaj*»

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Avocat Paris;

4. Periudha janar -maj 2009, Tiranë.

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: «*Shkolla e magistraturës në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit Spanjë*»

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Magistratura;

5. Periudha 2007, Tiranë.

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: «*Shkolla e Studimeve Europiane*»

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: bashkim Evropian dhe Diplomacia;

6. Periudha 2002-2007.

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: «*Certifikata të trajnimeve profesionale , të kurseve për gjuhët e huaja, për kompjuterin etj,*

30. Mbështetur në këto të dhëna të rezultateve në ushtrimin e detyrës, si dhe në tematikën e përmbajtjen e produkteve profesionale të lidhura me ushtrimin e detyrës apo edhe me ushtrimin e profesionit, Komiteti vlerëson se në **aspektin sasior** kandidati Saimir Hoxha ka tregues të lartë angazhimi profesional, i cili rezulton të jetë dukshëm përtej asaj që mund të gjykohet si një angazhim i zakonshëm apo “mesatar” në ushtrimin e profesionit. Për këto arsye, Komiteti çmoi ta vlerësojë kandidatin Saimir Hoxha për këtë kriter ligjor vlerësimi me **4 (katër) Pikë**.

31. Për sa i përket vlerësimit cilësor, Komiteti shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, veçanërisht pesë prej dokumenteve të përzgjedhura prej tij, me synimin për të evidentuar, bazuar në tregues shkencorë, elementë që dëshmojnë arritjen e rezultateve profesionale, shkallën e këtyre arritjeve, përfshirë elementë që nga këto dokumente profesionale dhe në tërësi nga veprimtaria profesionale e kandidatit dëshmojnë spikatjen dhe dallueshmërinë e tij në kuptimin dhe qëllimin për të cilin Kushtetuta dhe ligji e përcakton si kusht për vlerësimin e kandidaturës për këtë Komitet dhe, më tej, për përzgjedhjen e Inspektorit Jomagjistrat.

#### **5 dokumentet e përzgjedhura nga kandidati**

Me datë 25.11.2020 kandidati Saimir Hoxha, ka dorëzuar pranë Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, dokumentet e përzgjedhura si më poshtë:

- Dokument i llojit “Udhëzim për zbatimin e rregullave të sigurimit fizik të informacionit të klasifikuar, viti 2010”, gjithsej shtatë fletë;
- Dokument i llojit “Memo drejtuar Ministrin të Drejtësisë, viti 2010”, gjithsej tre fletë;
- Dokument i llojit “Konkluzione përfundimtare, viti 2008”, gjithsej tre fletë;
- Dokument i llojit “Kallëzim penal, viti 2019”, gjithsej dy fletë;
- Dokument i llojit “Ankim, viti 2020”, gjithsej tre fletë;
- Dokument i llojit “Ankim, viti 2018”, gjithsej katër fletë;



- Dokument i llojit “MEMO, viti 2010”, gjithsej katër fletë;
- Dokument i llojit “procesverbal, viti 2010”, gjithsej tre fletë;
- Dokument i llojit “MEMO, viti 2010”, gjithsej katër fletë;
- Dokument i llojit “Prezantim Instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve në drejtësinë për të mitur, viti 2016”, gjithsej katër fletë;

32. Në lidhje me tërësinë e dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidati **SAIMIR HOXHA** dhe, në veçanti, lidhur me pesë dokumentet profesionale të sipërcituara, për realizimin e vlerësimit profesional dhe të pikëzimit përkatës për këtë kriter ligjor vlerësimi, Komiteti shqyrtoi dhe bisedoi në mënyrë të posaçme dhe të kujdesshme përmbajtjen e tyre, duke u mbështetur mbi indikatorë shkencorë, sikurse janë orientime që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor.(shtojca nr.2)

33. Mbështetur në këto të dhëna të rezultateve në ushtrimin e detyrës, si dhe në tematikën e përmbajtjen e produkteve profesionale të lidhura me ushtrimin e detyrës apo edhe me ushtrimin e profesionit, Komiteti vlerëson se në **aspektin sasior** kandidati SAIMIR HOXHA ka tregues të lartë angazhimi profesional, i cili rezulton të jetë dukshëm përtej asaj që mund të gjykohet si një angazhim i zakonshëm apo “mesatar” në ushtrimin e profesionit. Për këto arsye, Komiteti çmoi ta vlerësojë kandidatin SAIMIR HOXHA për këtë kriter ligjor vlerësimi **si me sipër**.

34. Për sa i përket **vlerësimit cilësor**, Komiteti shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, veçanërisht pesë prej dokumenteve të përzgjedhura prej tij, me synimin për të evidentuar, bazuar në tregues shkencorë, elementë që dëshmojnë arritjen e rezultateve profesionale, shkallën e këtyre arritjeve, përfshirë elementë që nga këto dokumente profesionalë dhe në tërësi nga veprimtaria profesionale e kandidatit dëshmojnë spikatjen dhe dallueshmërinë e tij në kuptimin dhe qëllimin për të cilin Kushtetuta dhe ligji e përcakton si kusht për vlerësimin e kandidaturës për këtë Komitet dhe, më tej, për përzgjedhjen e Inspektorit Jomagjistrat.

35. Në veprimet përgatitore të kryera gjatë procedurave të verifikimit të kandidaturës, kandidati **SAIMIR HOXHA** ka paraqitur para Komitetin me shkrim se për qëllimet e procedurës së vlerësimit në kuadër të pikëzimit për “Kualifikimin e Përgjithshëm Profesional” dhe “Kualifikimin Shtesë Profesional”, ka përzgjedhur **pesë dokumentet profesionale** si më poshtë:

- Dokumentin e llojit “*Vendim i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë*”, gjithsej nëntëmbëdhjetë fletë;
- Dokumentin e llojit “*Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë*”, gjithsej dhjetë fletë;
- Dokument i llojit “*Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë*”, gjithsej dymbëdhjetë fletë;
- Dokument i llojit “*Vendim i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë*”, gjithsej katërmëdhjetë fletë;
- Dokument i llojit “*Vendim i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë*”, gjithsej pesëmbëdhjetë fletë;
- Dokument i llojit “*Vendim i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë*”, gjithsej njëzet e katër fletë;

36. Në lidhje me tërësinë e dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidati **SAIMIR HOXHA** dhe, në veçanti, lidhur me pesë dokumentet profesionale të sipërcituara, për realizimin e vlerësimit profesional dhe të pikëzimit përkatës për këtë kriter ligjor vlerësimi, Komiteti shqyrtoi dhe bisedoi në mënyrë të posaçme dhe të kujdesshme përmbajtjen e tyre, duke u mbështetur mbi indikatorë shkencorë, sikurse janë orientime që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor.(shtojca nr.2).

37. Dokumentat trajtojnë tematika në fushën e së drejtës në të cilën ka operuar ndër vite kandidati, përfshi ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ligjshmërisë së veprimtarisë administrative të organeve shtetërore, mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material e procedural në përmbushjen e detyrimeve të organit shtetëror si edhe të subjekteve dhe individëve në raport me të drejtat dhe detyrimet përkundrejt administratës publike.

38.Njëri nga indikatorët vlerësues të dokumenteve profesional është vlerësues të dokumenteve profesionale është **“Originaliteti dhe/ose impakti”**. Nisur nga profili profesional i kandidatis, përmbajtja e dokumentave të analizuarra dhe dobisë së tyre nga profesionistë të fushës apo grupeve të interesit, Komiteti vëren se dokumentacioni i paraqitur ofron një panoramë të elementëve të një qasje profesionale origjinale në trajtimin e çështjeve ligjore të përbarimit. Për rrjedhojë krahas disa elementëve të origjinalitetit në përmbushjen e detyrës për aq sa e lejon natyra e funksionit publik të ushtruar duke sjellë argumenta në dobi të punës në praktikën gjyqësore si dhe mirëfunksionimin e administratës publike.

38. Për rrjedhojë pas shqyrtimit të dokumentacionit, në zërin **“Originaliteti dhe impakti”**, Komiteti e vlerëson kandidatin me **4 (katër) pikë**.

39. Për sa i përket treguesit vlerësues të lidhur me **“Aftësitë analitike”**, Komiteti tregon se në të vërtetë duke u përqëndruar në vendimet e gjykatës dilet në konkluzionin se parashtrimet e bëra nga përfaqësuesja e administratës publike tregojnë dhe dëshmojnë zotërimin e aftësisë profesionale të kandidatis për të arsytuar dhe zbatuar konceptet ligjore në fushën e operimit.

40. Për rrjedhojë , pas shqyrtimit të analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me zërin **“Aftësitë analitike”**, Komiteti vlerëson kandidaten me **3 (tre) pikë**.

41. Në lidhje me treguesin **“Aftësitë kërkimore”**, Komiteti shqyrtoi dokumentacionin profesional të paraqitur nga kandidati.

42. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me treguesin **“Aftësitë kërkimore”**, Komiteti e vlerëson kandidatin me **3 (tre) pikë**.

43.Referuar kriterit **“Saktësia dhe precizoni”**, në thelb verifikohet nëse në veprimtarinë e tyre profesionale, kandidatët kanë mbuluar me profesionalizëm tematikën e përzgjedhur duke shmangur përsëritjet në material. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, për aq sa është e mundur nga lloji i dokumentacionit, Komiteti vëren nivel të mjetueshëm të përcaktimit të tematikës dhe problemeve juridike.

44. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me treguesin “*Saktësia dhe precizoni*”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **2 (dy) pikë**.

45. Referuar kriterit “*Qartësia*”, në thelb verifikohet nëse në veprimtarinë e tyre profesionale, kandidatët e kanë strukturuar tematikën dhe problemin duke qartësuar gjuhën dhe duke përdorur në mënyrë të kënaqshme terminologjinë profesionale. Në rastin konkret , nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, për aq sa është e mundur nga lloji i dokumentacionit, Komiteti vëren nivel të kuptueshëm të parashtrimeve.

46. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me treguesin “*Qartësia*”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **3 (tre) pikë**.

47. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, që përbëjnë **vlerësimin cilësor** të kandidatit, Komiteti vendosi të vlerësojë kandidatin me **15 (pesëmbëdhjetë) pikë**.

### **C.MERITA PROFESIONALE-KUALIFIM SHITESË PROFESIONAL**

48. Rezultatet profesionale në lidhje me këto kriter vlerësimi, shqyrtohen nga Komiteti për të vlerësuar vecanerisht rëndësinë dhe dobinë e profilizimit dhe specializimit të arritur në përvojat e vecanta profesionale të kandidatit të cilat tregojnë vlera të spikatura profesionale në shërbim të drejtimit, organizimit dhe funksionimit të Inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. si edhe të ushtrimit të kompetencave të kësaj Institucioni. përfshirë këtu vlerësimin e njohurive të posaçme profesionale në lidhje me ushtrimin e kompetencave të kontrollit, inspektimit, hetimit dhe disiplinore si edhe kompetencave të tjera që përcaktohen nga ligji.

49. Prandaj, në zbatim të ligjit, në varesi edhe të profileve dhe karrierave profesionale të secilit kandidat, nga totali prej 10 pikësh për këto kategori vlerësimi, Komiteti, vlerëson deri në 7 pike ekspertizën në fushat e së drejtës dhe posaçërisht në çështjet e drejtimit, organizimit dhe funksionimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si dhe ushtrimit të kompetencave me natyrë kontrolli, inspektimi, hetimi disiplinor si edhe kompetencave të tjera që përcaktohen nga ligji. Gjithashtu, Komiteti vlerëson deri në 3 pike angazhimet profesionale shtesë të kandidateve. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara në Urdhërin nr. 7 (si më sipër) të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe orientimet në përcaktimin e pikeve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikeve për renditjen e kandidateve .

50. Në rastin e kandidatit, krahas jetëshkrimit, intervistës, motivimit për kandidim si edhe mendimit të vëzhguesit, Komiteti shqyrtoi dokumentet profesionale .

### **Angazhime profesionale shtesë:**

51. Nga aktet e dosjes dhe nga vetëdeklarimet e kandidatit SAIMIR HOXHA, rezulton se ka paraqitur angazhime shtesë profesionale, krahas atyre që janë përmendur në këtë vendim. Angazhime të cilat gjenden jo vetëm të përmendura në jetëshkrim por edhe bashkëngjitur dosjes së kandidatit.

52. Për këtë arsye Komiteti i emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve për kriterin vlerësues të “Angazhimeve profesionale shtesë”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **3 (tre) pikë**.

### ***Dokumentat që vërtetojnë rezultatet e procesit të vlerësimit profesional***

53. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se kandidati vlerësohet nga Komiteti me **6 (gjashtë) pikë**.

### **MERITA MORALE**

55. Si kriter vlerësimi është percaktuar që kandidatet të jenë vlerësuar për integritet të lartë moral dhe profesional. Konkretisht percaktohen si kriterë vlerësimi edhe "*Repulacioni qe gezon kundidati ne shoqeri dhe midis kolegeve*" dhe “cilësi morale të tilla si: Ndërshmëria, përpikmëria, drejtësia në marjen e vendimeve dhe ushtrimin e detyrave” si edhe "angazhimi i provuar ne ndjekje të kauzave të shoqërisë civile”.

56. Prandaj, ne zbatim te ligjit, lidhur me meritat morale, nga totali prej 25 pikesh per te tre komponentet vleresues, Komiteti vlereson deri ne 15 pike integritetin etik dhe moral, deri ne 8 pike reputacionin qe gezon kandidati ne shoqeri dhe midis kolegëve dhe deri ne 2 pike angazhimit e provuar ne ndjekje te kazuave të shoqërisë civile.

57. Ne rastin e kandidatit, krahas jeteshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes parashtrimeve ne interviste, motivimit per kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatit me Komitetin gjate procesit te verifikimit dhe vleresimit te kandidatures. Komiteti shqyrtoi te dhenat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit. si edhe cdo te dhene a dokument tjetër të aksesueshem publikisht nepermjet te cilave mund te nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vleresimit te meritave morale te kesaj kandidateje.

### **INTEGRITETI ETIK E MORAL**

58. Per sa i perket kriterit te pare vleresues, integritetit etik e moral, nisur nga te dhenat qe rezultojne nga jeteshkrimi, motivimi per kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Komitetin gjate procedurave te verifikimit dhe vleresimit, si edhe nga dokumente te tjera zyrtare apo te aksesueshme publikisht, Komitetit i rezulton se kandidati ne veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e saj tregon perkushtim dhe angazhim të ndërgjegjshëm në përmbushjen e detyrave

profesionale dhe ne ushtrimin e profesionit, si edhe vemendje, ndjeshmeri dhe respekt ne komunikim e bisede, duke parashtruar argumentat e tij me kompetence, dinjitet, duke degjuar dhe pergjigjur me kujdesin e duhur, me durim e vetëpërbajtje perkundrejt qendrimeve dhe pyetjet te cilat i drejtohen nga bashkebiseduesit.

**59.** Nga te dhenat e mundshme ne dispozicion, Komitetit nuk i rezullon qe kandidati te ushtroje apo te kete ushtruar funksionet e saj profesionale duke favorizuar pale te caktuara apo duke kerkuar perfitime per veten apo per te tjeret. Nuk rezultojne le dhena qe kjo kandidate te mos kete respektuar detyrimin profesional te nderit dhe te dinjitetit, të ndertimit te marredhenieve profesionale dhe miresjelljes ne raport me koleget, profesionistet e fushes, palet e perfshira ne ceshtje pune etj .. Pra nuk ka te dhena qe me sjelljen dhe veprimtarine e saj ne jeten profesionale dhe personale te kete cenuar apo te rrezikoje te cenoje imazhin dhe figuren publike te nepunesit shteteror dhe sistemit te drejtesise.

**60.** Prandaj, ne lidhje me kriterin vleresues te "*integritetit etik e moral*", Komiteti e vlereson kandidatin me **15 (pesembedhjete) Pike**.

#### ***Reputacioni në shoqëri dhe midis kolegëve***

**61.** Per sa i perket kriterit te dytë vlerësues të reputacionit që gezon kandidati në shoqëri dhe midis kolegeve", nisur nga te dhenat qe rezultojne nga jeteshkrimi, motivimi per kandidim. Intervista, komunikimi i kandidatit me Komitetin gjate procedurave te verifikimit dhe vleresimit, si edhe nga dokumente te tjera zyrtare apo te aksesueshme publikisht, Komitetit i rezulton se kandidati me veprimtarinë dhe sjelljen në shoqëri, tregon angazhim dhe përkushtim në përbushjen e detyrave për zbatimin e drejtë të ligjit në ushtrimin e kompetencave që i ngarkon ligji.

**62.** Prandaj, duke konstatuar se me sjelljen dhe veprimtarine e tij permbush te gjitha pritshmerite e aspektit moral per marjen e pergjegjesive ligjore dhe institucionale, si edhe pritshmerine e publikut per gezimin e cilesive profesionale e morale per ushtrimin e detyres se Inspektorit te Larte te Drejtesise, ne lidhje me kriterin vleresues "të reputacionit që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve", Komiteti e vlerëson kandidatin me **8 (tetë) pikë**.

#### **Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile**

**63.** Per sa i perket kriterit te trete vleresues "Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile", nisur nga te dhenat qe rezultojne nga jeteshkrimi, motivimi per kandidim, intervista, komunikimi i kandidates me Komitetin gjate procedurave te verifikimit dhe vleresimit, si edhe nga dokumente te tjera zyrtare apo te aksesueshme publikisht, Komitetit i rezulton se, pergjithesisht, kandidati nuk ka qene e angazhuar në veprimtari te tjera të pershtatshme jashte atyre te lidhura me ushtrimin e detyres ose te profesionit per ndjekje te kauzave te shoqerise civile.

64. Prandaj, ne lidhje me kriterin vlerësues te “**Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile**”, Komiteti e vlerëson kandidaten me **O (zero) Pike**.

#### **MERITAT ORGANIZATIVE, DREJTUESE DHE MENAXHERIALE**

65. Ky komponent zërthehet në disa nën komponentë të tjerë, konkretisht:

- a) cilesine e platformes dhe te vizionit qe paraqesin;
- b) aftesite e provuara per te marre vendime dhe pergjegjesi bazuar ne pervojat e meparshrne profesionale dhe shoqerore;
- c) aftesite e komunikimit;
- d) aftesite e te punuarit ne grup dhe ne ambiente multidisiplinore ose multikulturore;
- dh) aftesite e perfaqesimit publik."

66. Ne baze dhe per zbatim te ligjit, lidhur me keto kritere vleresimi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar Urdhrin Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “*Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*” ku percaktohen rregullime me te hollesishme si edhe shperndarja e pikeve te vleresimit sipas peshes specifike te ketyre kritereve.

67. Prandaj, ne zbatim te ligjit, lidhur me meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale, nga totali prej 25 pikesh per të pese komponentet vleresues te sipercituar, Komiteti vlereson deri ne 8 pike cilësinë e platformës dhe vizionin qe paraqesin kandidatet, deri ne IO pike aftësitë e provuara për të marë vendime dhe pergjegjesi bazuar ne përvojat e meparshme profesionale dhe shoqerore, deri ne 5 pikë aftësisë e komunikimit dhe aftesite e përfaqësimit publik, si edhe me 2 pike per aftësitë e të punuarit në grup dhe ambiente multidisiplinore.

Ne arsyetimin dhe perfundimet e tij, Komiteti mban parasysh rregullat e hollesishme te percaktuara me Urdhrin Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “*Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Shtojcën nr. 2 te tij si edhe orientimet ne percaktimin e pikeve perkatese te merituar sipas Metodologjise per vleresimin dhe caktimin e pikeve per renditjen e kandidateve per Inspektor* .

68. Komiteti shqyrtoi permbajtjen e dokumentit me shkrim, platformës dhe arsye ti apo motivet e kandidimit dhe vizionit te kandidatit lidhur me qasjen dhe qendrimit e tij mbi rendesine dhe aspektet thelbesore te ushtrimit te detyres se Inspektorit, mbi sfidat kryesore me te cilat duhet te perballtet Inspektori i Larte i Drejtësisë ne ushtrimin e pergjegjesve dhe kompetencave qe i ngarkon Kushtetuta dhe ligji, si edhe lidhur me mendimet e kandidatit per ceshtjet qe duhet te trajtohen me

perparesi e ne perspektive per mireorganizimin dhe mirefunksionimin e ketij institucioni te ri dhe shume te rendesishem kushtetues, per ushtrimin efektiv dhe me nivel te larte profesional e besueshmerie te kompetencave te tij ne funksion te ndertimit te nje sistemi drejtesie të bazuar ne integritetin profesional e moral, nisur edhe nga pritshmerite e jashtezakonshme të publikut pas miratimit dhe venies ne zbatim te reformes ne drejtesi. Gjithashtu, ne vleresimin e ketij kriteri, Komiteti mban parasysh edhe parashtrimet dhe shpjegimet e dhena nga ky kandidat gjate intervistës dhe ne pergjigje te pyetjeve qe iu drejtuan nga anetaret e Komitetit.

69. Nisur nga dokumenti me shkrim dhe shpjegimet e paraqitura gjate intervistes, Komiteti veren se kandidati paraqiti nje nivel mbi mesatar te njohjes dhe pervojes profesionale se saj ne lidhje me rolin dhe pritshmerite per ushtrimin e funksionit te Inspektorit jomagjistrat pranë zyrës së Inspektorit te Larte te Drejtesise, si edhe elemente premtues qe tregojne cilesi, thellesi dhe origjinalitet per sa i perket sfidave me te cilat do te perballlet fillimisht krijimi i ketij institucioni, objektivat per ceshtjet e organizimit dhe funksionimit cilesor dhe efektiv të institucionit te ri kushtetues te Inspektorit te Larte te Drejtesise duke u vene theksin te pavaresia e tij, respektimi i procesit te rregullt ligjor, zhvillimi i marredhenieve me publikun.

70. Prandaj, ne lidhje me kriterin vlerësues *"Cilësia e platformës dhe vizionit të paraqitur"* nga kandidatet, Komiteti e vlereson kandidatin e **6.6 (gjashtë pik gjashtë) Pike.**

#### **Aftësitë e provuara për të marë vendime dhe përgjegjësi, bazuar ne pervojat e mëparshme profesionale shoqërore**

71. Lidhur me aftesite e provuara per te marre vendime dhe pergjegjesi, Komiteti mbeshtetet pikesepari ne te dhenat qe lidhen me pervoja konkrete nga karriera e kandidateve ne funksione dhe pozicione te cilat kerkojne dhe tregojne marrjen persiper te pergjeggjesive dhe ushtrimin e vendimmarrjes ne permbushjen e kompetencave dhe të detyrave te ngarkuara, vecanerisht per aspektet e drejtimit dhe te administrimit te puneve. Ne kete drejtim. Komiteti shqyrton dhe vlereson posacerisht aftesite e provuara ose premtuese per te marre nisma, per te kerkuar zgjidhje, per te marre pergjegjesite si edhe per te marre ne vendimet c duhura e ne kohen e duhur sipas percaktimeve te ligjit dhe ne pergjigje te ndjeshmerise se publikut.

72. Ne rastin e kandidatit, krahas jeteshkrimit, parashtrimeve dhe bisedes ne interviste, permbajtjes se platformes dhe motivimit per kandidim, Komiteti shqyrtoi te dhenat nga dokumentet profesionale, si edhe aktet e tjera zyrtare te administruara ne dosjen e kandidates. per te evidentuar te dhena ne lidhje me aftesitë e provuara apo premtuese te ketij kandidati per te marre vendime dhe pergjegjesi edhe ne ushtrimin e funksionit te Inspektorit te Larte te Drejtesise.

73. Prandaj, ne lidhje me kriterin vleresues *“aftesite e provuara per le marre vendime dhe pergjegjesi bazuar ne pervojat e meparshme profesionale dhe shoqërore”*, Keshilli e vlereson kandidaten kandidatin me **6 (gjashtë) Pike**.

#### **Aftesite e komunikimit dhe aftësite e përfaqesimit publik**

74. Aftesite e komunikimit, ne te gjitha format, vecanerisht me nepunesit dhe punonjesit e Zyres se Inspektorit te Larte te Drejtesise, me organet e tjera te qeverisjes se sistemit te drejtesise dhe perfaqesuesit e tyre, me gjyqtaret dhe prokuroret, sikurse edhe ne komunikimin dhe perfaqesimin publik e me te tretet, te shprehurit ne menyre te qarte. lehtesisht te kuptueshme, te matur, me respekt dhe ne menyre jodiskriminuese, luajne një rol te rendesishem ne kryerjen e funksionit kushtetues te Inspektorit te Larte te Drejtesise.

75. Nga shqyrtimi i jeteshkrimit, mënyra dhe stili i parashtrimeve me shkrim te platformes, sjellja, menyra e komunikimit dhe argumentimit gjate bisedes ne interviste, si edhe nga permbajtja, strukturimi dhe stili i hartimit te dokumenteve profesionale te administruara ne dosjen e kandidatit, Komiteti veren se kandidati zotëron aftësi të mjaftueshme per te komunikuar me maturi, per te degjuar me respekt dhe per tu pergjigjur me profesionalizem. qartesi e thjeshtesi, me stil dhe gjuhe te pasur ne lidhje me te gjitha ceshtjet dhe problematikate qe vlereson te trajtohen, ashtu edhe per ceshtje dhe problematika qe ngrihen nga te tjeret.

76. Gjithashtu. referuar prezantimit te bere gjate intervistes, rezulton se ky kandidat zoteron edhe aftesi te mira per perfaqesimin publik, prezanton thjeshtesi, aftesi per te shprehur bindjet e tij me vetebesim. Kandidat transmeton besueshmeri gjate komunikimit dhe aftesi per tu pergjigjur me etike.

77. Prandaj, ne lidhje me kriterin vleresues te " **Aftesite e komunikimit dhe aftësite e përfaqesimit publik**", Komiteti e vlereson kandidatin me **4 (katër) Pike**.

#### **Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore**

78. Inspektori i Larte i Drejtesise, per vete natyren e ketij institucioni dhe funksioni, duhet të zoteroje aftesite e duhura per nje qasje metodike ndaj punes, si dhe aftesine per te organizuar dhe per te qene i perfshire ne punen ne grup, me nepunesit dhe punonjes e Zyres se tij dhe per aq sa kerkohet dhe nevojitet me funksionare e perfaqesues te institucioneve te tjera. Pjese e kesaj aftesie eshte edhe nevoja per t'u pershtatur shpejt me zhvillimet e reja, si edhe ndaj nevojës per tu perfshire ne veprimtari ne ambiente multikulturore dhe multidisiplinore gjate karrieres gjyqesore.



79. Nga shqyrtimi i jeteshkrimit, sjellja, menyra e komunikimit dhe argumentimit gjate bisedes ne interviste, si edhe nga dokumentet profesionale te administruara ne dosjen e kandidatit, Komiteti veren se kandidati zoteron aftesite e duhura per te punuar ne grup, perfshire ate per te punuar ne ambiente multikulturore dhe multidisiplinore.

80. Prandaj, ne lidhje me kriterin vleresues “Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore”, Keshilli vlereson ti caktojë kandidates **2 (dy) pikë**.

### Vlerësimi përfundimtar i kandidatit

81. Ne përfundim të arsytimit mbi mënyrën dhe shkallën e vlerësimit për të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga ligji dhe të pikëzimit përkatës të treguar me sipër në këtë Vendim, në funksion të procedurave ligjore të perzgjedhjes së Inspektorit Jomagjistrat dhe për efekt të renditjes së kandidatëve për këtë vend vakant, Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve i rezulton se kandidati SAIMIR HOXHA vlerësohet në total **me, 72.3 (shtatëdhjetë e dy pik tre) pike**.

### PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë:

### VENDOSI:

1. Vlerësimin e kandidatit SAIMIR HOXHA, **72.3 (shtatëdhjetë e dy pik tre) pike**, në lidhje me kandidimin e tij për vendin vakant **Inspektor Jomagjistrat**, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020.
2. Ky vendim i njoftohet kandidatit SAIMIR HOXHA.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në pjesën e përcaktuar për “Rekrutim Inspektor Jo magjistrat”.

ANËTARE  
Mirela KAPO

17 Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr. 13, Tiranë Tel: + 355 4 2217217

ANËTARE  
Marsela PEPI

REPUBLIKË SHQIPRE  
KRYETARI  
Artur Metani

<http://www.ild.al> [info@ild.al](mailto:info@ild.al)